


# BESIMTARI


Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër  
Viti II i botimit, Nëntor 2008 Nr. 19. Çmimi 20 lekë.  
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj



## FESTA MADHESHTORE E KURBAN BAJRAMIT

**K**urbani është një akt të cilin njërezit e kanë bere ne emer te sakrifices, heroizmit, bindjes dhe per shume arsye te tjera qe kanë qene motiv per kryerjen e nje akti te tille, akt ky qe ka qene pjese ejetes se shoqerise njerzore. Eshte i njohur fakti se kurban është një adhurim qe perfshin te gjitha fete, sepse, ne Kuranin e Madherishem, Allahu xh.sh, ne suren(Haxh 34), thote "Ne i caktuam secilit popull kurbanin" Kurban është dukuri qe njihet qe ne kohen e Adem it a.s., kur dy djemte e tij bene dy kurbane per Allahun xh.sh., ku njeri iu pranua , kurse tjetri jo. Historiku i Kurban Bajramit është i lidhur me Profetin Ibrahim te cilit Allahu xh. sh. i kerkoi qe te beje kurban djalin e tij, Ismailin, per te shprehur dashurine ndaj Allahut xh.sh. e cila qendron mbi te gjitha dashurite e tjera. Pasi Ibrahim i a.s. shikoi nje ender ku Allahu e urdheronte te bente kurban djalin, Ismailin, ai, se bashku me te birin, ishin te gatshem te zbatonin urdherin e Allahut xh.sh., sepse vete Ismaili i tha Ibrahim it a. s. qe urdheri i Allahut duhet te zbatohet dhe u shtri i gatshem qe te sakrifikohej per Allahun xh.sh. Por, Allahu xh.sh. e quajti te zbatuar urdherin e tij qe ne momentin, kur Ismaili u shtri ne kembet e Ibrahim it a.s. per t'u bere kurban per dashurine ndaj Allahut xh .sh .Ne suren (Safate) thuhet: "O Ibrahim! Ti e permbushe enderen. Ne keshtu i shperblejme bamiresit. Kjo ishte nje sprove e madhe dhe e qarte. Ne e shpaguam (Ismailin ) me nje kurban te madh". Me kete veprim qe beri, Ibrahim i a.s u quajt mik i Allahut xh.sh., sepse sprova e tij ishte e pashembullt ne historine e njerzimit Ishte Profeti une i nderuar, Muhamedi a.s., i cili e trashегоi kete tradite te profeteve paraardhes duke



kultivuar tek ummeti i tij musliman ndjenjen e sakrifices dhe te flijimit per hir te Allahuxh.sh. Urdheri per therjen e Kurbanin si detyrim per muslimanet erdhi ne Meke me shpalljen e sures "Kevther" ku thuhet: "Ne te vertete te dhame ty shume te mira. Prandaj, falu dhe pre kurban per hir te Zotit tend"

Besimtarete dhe tegjithe te tjeret duhet te dine se adhurimet behen, sepse jane urdher i Allahut xh.sh. dhe jane dukuri e urtesise se tij. Kur muslimani e ben kurbanin me "Bismillah" para therjes se kurbanit, behet e njohur se te gjitha kafshet ne planet jane prone e Allahut xh.sh. i cilit ia ka dhuruar njerezve qe te keni dobi prej tyre. Kurban Bajrami sherben per te forcuar bashkepunimin ,vellazerine, barazine ne mes te muslimaneve dhe njekoheisht kultivon shpirtin e sakrifices dhe dashurine ndaj Allahut xh.sh. Muslimanet ,qe bejne kurban, ndihmojne te varferit dhe i kundervihen kopracise, sepse ata jane bere

pjese e vellazerise muslimane. Por, ata qe i kane mundesite per te bere kurban, jane te denuar, rende, kur nuk e realizojne kete detyrim fetar. Profeti, Muhamedi a.s., ne nje hadith ka thene se ata qe kane mundesi per te bere kurban dhe nuk e bejne, jane te ndaluar t'u afrohen faltoreve tona. Por, edhe ata qe jane te detyruar te bejne kurban duhet te jene se pari muslimane, te jene me mendje normale, te mos jene udhetare dhe te kene mundesi financiare. Po keshtu është percaktuar edhe kafsha qe mund te behet kurban duke theksuar se ajo duhet te jete dele, dhi, buall, deve dhe kafshe te ngjashme me keto. Nuk lejohet te theret per kurban rosa ,pula dhe shpende te tjere. I pelqyer mbetet per kurban gjithmone dashi. Delja dhe dhite duhet te jene nje vjecare, por kur delja është 6 muajshe dhe e shendoshe, ajo mund te theret per kurban. Dhia duhet te jete gjithmone nje vjecare e gatshme per kurban. Lopa dhe bualli duhet te jene dy vjec. Kurse deveja

duhet te jete 5 vjece. Delja dhe dhija behen kurban vetem ne emer te nje personi. Kurse lopa dhe bualli mund te behen kurban edhe ne emer te 7 personave. Pasi theret, kurbani ndahet ne menyre te barabarte ne mes te 7 personave qe e kane bere kete kurban.

Kafsha qe behet kurban duhet te jete e shendoshe ,e majme dhe jo e semure, sepse cenohet vlера e adhurimit dhe e shendetit te atyre qe e konsumojne mishin e Kurbanit. Duhet te kemi kujdes qe kurban te theret kur mbaron namazi i Kurbanit deri ne ditën e trete te Kurban Bajramit. Nuk lejohet te behet kurban nje kafshe qe ka nje sy ,ose te dy te qorruar, ose nuk është ne gjendje te ece. Nuk lejohet edhe kur ka nje vesh ose dy te prere dhe i mungojne shume dhembet, ose te gjitha dhembet. Muslimani duhet te kete kujdes, kur ther kurbanin . Pofeti yne i nderuar porositi qe thika te jete mbrehur mire qe kafsha te mos mundohet. Kafsha duhet te shtrihet ne drejtim te kibles nga ana e majte dhe ate mund ta there personi qe e ben kurbanin, ose nje njeri tjetër. Thika mbahet me doren e djathte dhe ne momentin e therjes duhet thene; "Bismil-lahi, Allahu Ekber" Kafsha duhet te theret ne dy anet e damareve te qafes dhe duhet t'i rrjelle gjaku, pasi te jete therur dhe duhet rjepur kur kafsha kur ajo nuk levize me. Rendesia e berjes se Kurbanit është vene ne dukje nga Allahu xh.sh.; kur Ai thote ne suren (Haxh37): "Mos harroni se as mishi, as gjaku nuk do te shkojne tek zoti. Ajo qe arrin deri atje është devotshmeria qe ushqeni ne zemrat tuaja dhe respekti ndaj Allahut xh.sh."

Materjalin e pergaditi  
Imam Kujtim Cufaj

## GEZUAR DHE PERSHUMEVEJT KURBAN BAJRAMIN



# Përdorimi politik i islamofobisë në Shqipërinë paskomuniste

**N**jë nga politikanët socialistë që ka sulmuar identitetin Islam të shqiptarëve në mënyrë të hapur dhe agresive në këto vitet e fundit ka qenë edhe Fatos Nano, i cili ka shërbyer si kryeministër i Shqipërisë në intervalet e viteve 1997-2005. Kur partia e tij mori pushtetin nga Berisha më 1997, Nano deklaroi se qeveria e tij do të fshinte historinë e 555 vjetëve të fundit të Shqipërisë, duke iu referuar kështu

periudhës osmane dhe pasuesve të saj. Një vit më vonë ai deklaroi se qeveria e tij do të luftojë pa mëshirë 'krimin ordiner, politik dhe islamik',<sup>20</sup> duke e cilësuar kështu Islamin si një lloj krimi, i cili duhet luftuar. Ndërsa në vitin 2003, kur muslimanët e Elbasanit protestuan kundër grabitjes së pronave të Namazgjasë të qytetit të tyre nga qeveria, Nano i bëri thirrje popullit të Elbasanit, që të kundërshtonin këtë protestë, duke iu apeluar që të mos votojnë "ferexhetë politike" të kundërshtarit, por midis Haxhi Qamilit dhe Kostandin Kristoforidhit të zgjedhin këtë të fundit.<sup>21</sup> Siç mund të kuptohet nga ky tekst, Nano i sheh ferexhetë e grave muslimane dhe Haxhi Qamilin, si diçka që i përkasin të shkuarës së zymtë. Ndërsa modernizimin e portretizon si të lidhur me heqjen e ferexhesë dhe të udhëhequr nga të krishterët, si Konstandin Kristoforidhi. Islamofobia politike arriti kulme të reja në Shqipëri gjatë vitit 1998, kur amerikanët ekstraduan nga Shqipëria disa arabë të dyshuar për përfshirjen në akte terroriste. Socialistët që në këtë kohë ishin në pozitë e përdorën fushatën amerikane për të akuzuar Berishën si njeri që kishte lidhje me fundamentalizmin ndërkombehtar. Lufta e administratës amerikane kundër terrorizmit u shoqërua me një rritje hysterike të islamofobisë mediatike në vend, ku tashmë sulmet kundër Islamit nuk vinin vetëm nga Partia Socialiste, por edhe shumë OJQ të sponsorizuara nga amerikanët dhe fondacioni Soros. Një shembull i kështillë është artikulli i Remzi Lanit dhe i Fabian Schmidit me titull "Politika e jashtme shqiptare ndërmjet gjeografisë dhe historisë".<sup>22</sup> Në këtë artikull, Lani, i cili është drejtori i Institutit të Medias Shqiptare<sup>23</sup> dhe një nga drejtorët e bordit të Fondacionit të Shoqërisë së Hapur,<sup>24</sup> së bashku me Schmidin që është gjerman jepnin përshtypjen, se qeveria e Berishës ishte anti-amerikane dhe anti-evropiane, meqë Berisha e kishte anëtarësuar Shqipërinë në Organizatën e Konferencës Islamike.

Roli i OJQ-ve të sponsorizua nga Sorosi në nxitjen e islamofobisë në Shqipëri mund të shihet edhe në shumë shembuj të tjerë. Këtu mund të përmendim organizatën "MJAFT", e cila në Nëntor 2006 publikoi në revistën 'Mapo' karikaturat e profetit

Muhamed.<sup>25</sup> Megjithatë personi më shqetësues i rrejtës të të paguarve nga Fondacioni Soros, që ka nxitur valë të frikshme islamofobie në Shqipërinë e viteve të fundit ka qenë Pirro Misha, i cili ka shërbyer për një kohë të gjatë, si një nga drejtorët e bordit të Fondacionit të Shoqërisë së Hapur në Tiranë dhe organizata e tij "Instituti i Dialogut Publik & Komunikimit", që mbahet me paratë e Sorosit ka nxitur shumë polemika në shtypin shqiptar me deklaratat e tij anti-islame të këtyre dhjetë viteve të fundit. Ai ka sulmuar në mënyrë të vazhdueshme anëtarësimin e Shqipërisë në OKI,<sup>26</sup> dhe nën pretekstin e asaj, që ai e quan ruajtje të "Islamit shqiptar" nga "Islami arab" ka bërë thirrje për izolimin e muslimanëve shqiptarë nga bota islame, e madje ka kërkuar edhe izolimin shoqëror të shkruarit të këtij shkrimi.

Ndryshe nga Kadareja, i cili përbuz "Islamin turk" të otomanëve, Misha është i shqetësuar nga "Islami arab", i cili sipas tij po zëvendëson "Islamin shqiptar" në Shqipëri, dhe kjo sipas tij përbën një kërcënim kombëtar. Ashtu si Kadareja, edhe Misha ka qenë në të kaluarën një komunist i flaktë, që shkruante novela demonizuese kundër turqve dhe ngrinte lart komunizmin.<sup>27</sup> Megjithatë pas rënies së komunizmit Misha ashtu si edhe Kadareja ka përdorur një zhvendosje paradigme, pasi tanimë e mira e madhe për Mishën nuk është më komunizmi, por kristianizmi perëndimor, i cili ndjehet i kërcënuar, jo më nga kapitalizmi, i cili përbënte të keqen e madhe në periudhën e Enver Hoxhës, por nga Islami. Ngaqë Misha e sheh veten si mbrojtësin e kulturës korrekte në Shqipëri, arritjen e "Islamit arab" në vend ai e percepton si një kërcënim për kombin. Të keqen islame Misha e gjen te burrat muslimanë, që rrisin mjekrat dhe te gratë e mbuluarat me shami.<sup>28</sup> Artikujt e tij në mediat shqiptare kanë qenë të rëndësishëm në nxitjen e tensioneve islamofobike, por edhe politike në vend, të cilat kanë shkaktuar një seri reagimesh nga drejtuesit muslimanë, që kanë dënuar ashpër sulmet e tij.<sup>29</sup> Megjithatë për Mishën në Shqipëri 'Islam vendas' kërcënohet nga 'Islami i huaj', të cilin Misha e sheh te gratë që mbajnë shami në kokë. Këto shami sipas Mishës nuk mbahen për qëllime fetare, por për qëllime politike dhe me prapavijë politike nga ata që "refuzojnë modelet e simbolet perëndimore". Misha thotë që "është një dukuri që s'e ndeshim për herë të parë në historinë moderne.

Veshja është shpesh shenja e parë e pranimit apo refuzimit të modeleve.

Në Indi p.sh. gjëja e parë që bëri Mahatma Gandhi, kur nisi lëvizjen e tij kundër anglezëve ishte braktisja e xhakës dhe kravatës për t'u veshur me robën tradicionale indiane. Mao Ce Duni ndaloi veshjen

evropiane, duke imponuar uniformën "revolucionare". Në Iran, pas revolucionit islamik të Khomeinit, masa e parë e ndër-marrë ishte imponimi i një stili të caktuar veshjeje dhe sidomos mbulimi i grave. Pra, kemi të bëjmë me simbolikën

e një reagimi antiperëndimor e antieuropian, ku feja s'është veçse një pretekst, një element për të arritur mobilizimin emotiv në një projekt që në thelb mbetet politik. A s'ia vlen të hapet ky debat?"<sup>30</sup> Për këto arsye Misha mendon se lënia e mjekrës dhe mbulimi i grave muslimane janë thjeshtë një pretekst, i cili synon largimin e Shqipërisë nga perëndimi. 31 Sipas tij gratë e mbuluarat i përdorin veshjen e tyre për qëllime antiperëndimore dhe anti-evropiane, duke e përdorur fenë për qëllime politike. Prandaj Misha sugjeron

që Islami në Shqipëri duhet të drejtohet nga shteti, i cili vetëm në këtë mënyrë mund të ruajë "Islamin shqiptar" nga infektimi i tij me "Islamin" e armikut. Për këtë ai edhe i apelon organeve të pushtetit që të jenë vigjilente ndaj armiqve duke thënë: A s'është, pra, koha që shteti shqiptar të hartojë një politikë të qartë në çështjen e fesë, duke u ndërgjegjësuar se kjo është një fushë që s'mund të lihet jashtë vëmendjes në emër të bindjes naive se ne shqiptarët qenkemi ca qenie të veçanta, të lindura me një tolerancë fetare, të cilës s'ka armik që i bën dot gjë!<sup>32</sup> Manipulimet islamofobike, të cilat kanë shfrytëzuar frikën perëndimore ndaj Islamit, dhe kanë sajuar legjendën e "Islamit të armikut" dhe "Islamit tonë", kanë prodhuar shumë analistë në shtypin shqiptar të dhjetë viteve të fundit, të cilët kanë përdorur islamofobinë për të arritur përfitime politike dhe ekonomike. Persona si Pirro Misha, Ilir Kulla, Mustafa Nano, Fatos Nano, Fatos Tarifa dhe Damian Gjikhuri, janë disa nga emrat që kanë qenë në ballë të nxitjes së islamofobisë në Shqipëri dhe kanë përdorur si justifikim të sulmeve të tyre kundër Islamit mitin e "Islamit shqiptar" dhe "Islamit arab". Damian Gjikhuri një nga zyrtarët e lartë të Partisë Socialiste, që ka shërbyer si shef kabineti për ministrin e Rendit Publik në 2005, hartoi në vitin 2004 edhe një tezë gjysmake në shkollën Naval Postgraduate School të Kalifornisë, ku autori mbron tezën islamofobike të Kadares dhe socialistëve, se "shqiptarët kanë vuajtur njësoj si nga komunizmi ashtu edhe nga Islami" dhe që Shqipëria nuk duhet të jetë pjesë e Organizatës së Konferencës Islamike.<sup>33</sup> Ideja se të qenit i anëtarësuar në Organizatën e Konferencës Islamike do të thotë të jesh kundër Evropës është shprehur nga një numër i madh zyrtarësh socialistë, si p.sh., Fatos Tarifa,<sup>34</sup> i cili ka qenë ambasadori i Shqipërisë në Hollandë

dhe SHBA. Por socialistët si puna e Gjikhurit kanë shkruar edhe më tej me agre-

sionin e tyre kundër Islamit në Shqipëri, duke deklaruar edhe se Komuniteti Musliman në Shqipëri vuan nga një luftë e brendshme midis mbështetësve të Islamit shqiptar dhe të atij arab për ta kontrolluar atë.<sup>35</sup> Shumica e zyrtarëve socialistë, që në shumicën e rasteve i përkasin fesë ortodokse, ndërhyrjen e tyre në punët e brendshme të Komunitetit Musliman e kanë justifikuar me tezën se Komuniteti Musliman vuan nga një luftë civile ndërmjetatyre që mbështetësin 'Islamin arab' dhe patriotëve që ruajnë 'Islamin kombëtar'. Pra, duke i dhënë betejës brenda-islamike ngjyra patriotike, ata sugjerojnë që shteti të marrë në dorë KMSH-në për të ndërtuar kombëtarët, që ruajnë Islamin e mirë. Ama Islami që persona si puna e Kadaresë, Gjikhurit dhe socialistëve duan të ndërtojnë në Shqipëri, nuk është aspak Islam. Fabrikimi i "Islamit shqiptar" përkundër 'Islamit arab' është një shpikje, që drejtuesit e lartë të Partisë Socialiste prodhuan gjatë viteve të sundimit të tyre në Shqipëri për të justifikuar ndërhyrjet e tyre në punët e 'Islamit'. Islami që islamofobët ortodoksë kërkonin të ndërtojnë në Shqipëri është perifrastuar qartë nga ish-ambasadori Fatos Tarifa, i cili në një nga intervistat e tij në vitin 2006, kumbronte tezat e Kadaresë në lidhje me Islamin, Islamin shqiptar e cilësoi si një "islam scotchi dhe uiski", apo më saktë si një Islam rakie.<sup>36</sup> Megjithatë islamofobët ish-komunistë kanë patur një problem në definimin e versionit të saktë të Islamit herezi për Shqipërinë, sepse ndërsa për Kadarenë dhe regjimin komunist të të kaluarës, "Islami turk" gjendet i portretizuar si nëna e të gjitha të këqijave, i cili rrezikon të shkatërrojë "Islamin tonë", për islamofobët e tjerë, si Pirro Misha, Fatos Nano, Damian Gjikhuri etj., "Islami arab" është trajtuar si xhindi i frikshëm, i cili duhet mbajtur i kyçur në shishe. Dëshira për të krijuar versionin politikisht korrekt të "Islamit shqiptar" kanxitur në shumë raste zyrtare të lartë socialistë, si p.sh., Ilir Kullën, ish-kryetarine Komitetit të Kulteve gjatë qeverisjes së Fatos Nanos në 2005 të shprehi hapurdshirën e qeverisë së tij për të izoluar muslimanët shqiptarë nga bota e Islamit. Kur filloi punë në Komitetin e Kulteve, Kulla deklaroi hapur në media dëshirën që qeveria e tij kishte për të mos lejuar muslimanët shqiptarë të shkojnë për të studiuar në vende të huaja, pasi këto vende kishin realitete të tjera kulturore, etnike dhe politike nga ato të Shqipërisë.<sup>37</sup> Ndërsa në raste të tjera Ilir Kulla i ka kërkuar shtetit që të marrë nën kontroll Komunitetin Musliman të Shqipërisë<sup>38</sup> në një kohë kur kishat eshumta të pranishmenë Shqipëri kishin të drejtë të veprojnë sipas dëshirave të tyre.

Olsi Jazexhi  
(vijon nga nr. kaluar)



# PORTRET I REPUBLIKES ISLAMIKE TE IRANIT

**R**epublika Islami- ke e Iranit ndo- dhet ne zemren e Lindjes se Mesme dhe shtrihet ne nje siperfaqe me mbi 1 milion km. dhe ka nje popullsi me 70 milion banore duke qene njeko- hesisht ure qe lidh detin Kas- pik me Gjirin Persik Popullsia e Iranit ka klime te favorshme ku ne te njejten kohe, ne zona te ndryshme te Iranit, shikohen 4 stinet e vitit. Irani eshte pasardhes i nje qyteterimi te lashte, ku emigrimi i fiseve ariane drejt rrafshnaltes se Iranit ka filluar ne mijevjecarin e dyte para er. se re. Ne vitin 330, para er. se re, akameneidet formuan perandorine e madhe te Iranit qe u pasua nga qeverisje nga me te ndryshmet duke ardhur ne vitin 1979, kur nje kryegritje e madhe popullore rrezoi monarkine antipopullore te mbretit Riza Pahlevi dhe shpalli, me nje mbesh- tje absolute,

Republiken Islamike te Iranit, me udheheq shpirtor, imam Khomenin, qe ishte udhehe- qesi i kryengritjes popullore. Republika islamike e Iranit ne keto dekada te egzistences se saj ka arritje madheshtore qe lidhen me mbrojtjen e territorit nga lufta 8 vjecare me Irakun, rindertimi i vendit te demtuar dhe rritja e rolit te saj ne rajon dhe ne bote. Irani vazhdon te jete model i demokracise dhe pluralizmit, ku vota e drejper- drejte e popullit percakton or- ganet administrative nga me te uletat deri tek me te lartat. Pas

fitores se Revolucionit Islamik, ne Iran jane bere 28 zgjedhje ku kane konkuruar formacione nga me te ndryshme politike. Republika Islamike e Iranit eshte e njohur per nje zhvillim te papare te mediave. Sot, ne Iran botohen 140 gazeta ditore dhe 1100 revista. Duhet theksuar se disa gazeta arrijne te botohen deri ne 500 mije kopje ne dite, pa harruar se gazeta dhe revis- ta te shumta botohen ne gjuhen angleze, arabe, armene. Hapesi- ra politike dhe demokratike ka bere qe ne Keshillin Islamik te perfaqesohen edhe pakicat fetar- e dhe kombetare si; kristianet, hebrejte dhe pakica te tjera. Pasurite natyrore te Iranit jane te jashtezakonshme. Rezervat e naftes e vendosin Iranin ne vendin e 5 ne bote. Kurse ne prodhimin e gazit, Irani eshte vend i dyte ne bote pas Rusise. Ndertimim i digave eshte arritje e madhe per Iranin qe eshte ve- tem pas Kines dhe Turqise per kete tregues. Sot, Irani eshte nje shtet e paarritshem per mena- xhimin e ujrave, sepse atje jane ne ndertim e siper me shume se 100 diga. Prodhimet bujqesore jane krenaria e Iranit, sepse ai eshte vend i trete ne bote me 100 milion ton prodhime te tilla. Sot, Republika Islamike e Iranit ploteson nevojat e popullsise per mish gjedhi, per shpende, grure dhe elb. Ne vitin 2007, Republi- ka Islamike e Iranit eksportoi per here te pare 1 miljon ton grure. Telekomunikacioni eshte nje arritje e rendesishme per Iranin i cili, per numurin e telefonave

fiks ze vendin e trete ne Lindjen e Mesme dhe eshte nder vend- et qe ka me shume celulare ne te gjitha boten. Iranianet jane perdorues te mahnitshem te in- ternetit duke qene vend i pare ne Lindjen e Mesme dhe ne te gjitha Afriken Veriore. Republi- ka Islamike e Iranit po ecen me hapa te shpejta ne industrine e prodhimit te automobilave duke prodhuar 250 mije auto- mobile te llojeve te ndryshme ne vitin 2007. Tashme jane te njo- hura arrijtet e Iranit ne fushen e prodhorimit te energjise ber- thamore per qellime paqesore, pavaresisht perpjekjeve qe po ben bashkesia Perendimore per ta penguar Iranin ne kete drej- tim, duke synuar qe te pengojne zhvillimin e tij ekonomik. Irani po punon ne kete fushe si mase profilaktike, sepse do t'i pake- sohen burimet energjetike ne te e ardhmen. Irani po realizon zhvillimin e energjise bertham- ore duke respektuar te gjitha konventat nderkombetare te aprovuara per kete qellim. Re- publika Islamike e Iranit eshte vend i pare ne Lindjen e Mesme per kerkime shkencore ne fu- shen e mjekesise dhe rrallitet ne 10 vendet e para ne bote per ker- kime ne biologjine molekulare dhe ne teknologjine e klonimit. Sot, Irani ploteson 90 % te ne- vojave me ilace dhe ne klinikat e Iranit realizohen operacionet me te veshtira qe njeh shkenca e mjekesie. Republika Islamike e Iranit ka nje nivel te larte ar- simimi, sepse atje numerohen 2 milion e 400 mije studente, ku

femrat studente jane 1 milion e 230 mije, duke qene keshtu 51% nga 49% qe jane djemte. Shifrat jane te vitit 2007. Femra ne Iran eshte shume e perfaqesuar poli- tikisht, ku shume prej tyre jane te perfaqesuara ne parlament dhe ne qeveri. Ata mbajne sot 23% te posteve drejtuese ne in- stitucionet ekzekutive te vendit. Kurse, ne organizatat joqeve- ritare, grate jane aktiviste dhe drejtuese ne shumicen e ketyre organizatave qe ne numur jane 2500. Ne Iran jane botuar 8673 tituj librash me autore femra qe ka rritje 74% ne krahasim me 11 vite me pare. Mos te harrojme se ne Iran botohen 60 mije tituj lib- rash ne vit me 170 milion kopje. Ne vitin 2005, jane paraqitur ne festivalet nderkombetare 473 vepra me regjizore femra. Du- het evidentuar edhe aktivizimi i femrave iraniane ne aktivitetet sportive ku, ne viti 2006, pjese- marrja e tyre ne keto aktivite eshte rritur 40% ne krahasim me vitin 1996. Te gjitha keto te dhena tregojne se Republika Is- lamike e Iranit eshte nje shtet i fuqishem dhe i zhvilluar, duke u bere shembull edhe per ventet e tjera te rajonit dhe me gjere.

Armir Mucaj  
Anetar i kryesise se shoqates  
se miqesise  
Shqiperi – Vendet Arabe

## SHBA E SHPETOI IZRAELIN NGA RREZIKU I SADAM HUSEJNIT

Ne nje takim te bere ne fund te muajit nentor 2008 ne mes te ish- kryeministrit te Izraelit Olmer dhe te ish- presidentit amerikan Bush, te cilin e transmetuan me- diat kryesore ne te gjitha boten, u theksua bashkepunimi i shkelqyer ne mes te ketyre dy lidereve te rendesishem te politikës boterore dhe u evidentua mirekuptimi i plote qe ata paten per ngjarjet me

te rendesishme qe kane te bejne me interesat e amerikaneve dhe te izrailiteve ne rajonin e Lindjes e Mesme. Gjate takimit te zhvilluar ish-kryeministri Olmer falenderoi SHBA per eliminimin e nje rrezi- ku te madhe qe kercenonte egzis- tencen e Izraelit e cili ishte regjimi dktatorial i Saddam Hysejnit. Rre- zimi i Saddam Hysejnit dhe egze- kutimi i tij duket se ka qene edhe

kerkese e shtetit hebre i cili duket se e ka mbeshetur inkursionin e ushtrise amerikane ne Lindjen e Mesme. Falenderimi qe Olmer i ben Bushit tregon se amerikanet kane per te lare hesapet edhe me dy armi qe edhe me te rrezikhem rajon per Izraelin te cilet jane Siria dhe Irani. Prandaj, akuzat qe po u drejtohen pa nderprerje ketyre dy shteteve per terrorizem dhe per

arme berthamore duket se jane paraprirese per pergaditjet e nje lufte te re ne Lindjen e Mesme. Kujtojme se Olmer ushte hequr nga detyre e kryeministri per korrupsion dhe partia republikane e B+ushit ka humbur tashme zgjedhjet e fundit ne SHBA.

# REAGIM PUBLIK RRETH MESHES PER NENE TEREZEN

## Reagim: Shqiptarët në Kanada

Reagim publik rreth meshe për Nene Terezen te planifikuar për të shtunën Inderuariz.ambasadorBesnikKonci, Duke ruajtur respektin që kemi për postin tuaj tepër të rëndësishëm, ne, një grup shqiptarësh që jetojmë në Kanada po ju drejtohem me këtë letër të hapur publike për të shprehur indinjatën tonë të thellë në lidhje me një ftesë që ju i keni dërguar shumë shqiptarëve nëpërmjet emailit përpara disa ditësh. Indinjata jonë lidhet me përmbajtjen e mesazhit tuaj të dërguar më datën 6 tetor 2008, në të cilin ju ftoni bashkatdhetarët tanë në Kanada që të marrin pjesë në "meshën për 5 vjetorin e shugurimit të Nënë Terezës." Kjo meshë sipas njoftimit tuaj organizohet me ndihmën dhe iniciativën tuaj direkte. Indinjata jonë, lidhet me faktin që kjo iniciativë juaja është një shkelje flagrante e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e postit të ambasadorit të një vendi shekullar që ju përfaqësoni dhe paraqet një akt antiligjor dhe anti-konstitucional për të cilin, ne, si shqiptarë dhe banues në Kanada, ku ju na përfaqësoni, ndjehemi të keqpërfaqësuar dhe jemi të nxitur për këtë reagim. I nderuar z. Ambasador, iniciativa të cilën ju keni ndërmarrë për të "përkujtuar" përvjetorin e një evenimenti fetar bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Nenin 10 të së cilës thuhet shprehimisht që: 1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare. 2. Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjessëtyre-

nëjetëpublike. Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ju, si FUNKSIONAR SHEKULLAR i Republikës së Shqipërisë, jeni i obliguar me ligj që të rrini larg dhe të ruani institucionin që ju përfaqësoni nga iniciativave të këtilla fetare, të cilat rrezikojnë që të shihen edhe si tejmime të njërës besim ndaj tjetrit. Ceremonia që ju po organizoni në Kanada është një ceremoni tërësisht fetare, e cila feston kujtimin e një shtetase jo-shqiptare dhe figure fetare siç është Nënë Tereza. Së dyti në kundërshtim me postin tuaj shekullar dhe mbarëkombëtar që ju përfaqësoni, ju jeni duke thyer ligjin nëpërmjet organizimit të një ceremonie fetare, kur ceremoni të këtilla janë detyrë e njerëzve të fesë dhe jo e ambasadorit të një shteti shekullar sikur jeni ju. Së treti ceremonia që ju po organizoni synon përkujtimin e "5 vjetorit të shugurimit të Nënë Terezës." Akti i shugurimit është një ceremoni fetare katolike e cila përveç që për ju si një shtetar shekullar duhet të jetë një akt i vështirë për tu pranuar, pasi shugurimi i shenjtorëve katolikë bëhet mbi bazën e pretendimeve të mrekullive mbinatyrore të punëtorëve të Kishës, në anën tjetër është një ritual teologjikisht dhe logjikisht i papranuar si i vërtetë nga besimtarët shqiptarë të feve të tjera. Megjithë këto problematika që MESHHA përkujtuuese ndaj shugurimit të Nënë Terezës paraqet për postin tuaj, është se ju si FUNKSIONAR SHEKULLAR i taksapaguesëve të Republikës së Shqipërisë nuk keni të drejtë të ndërmerri iniciativa të këtilla të cilat shkojnë në konflikt flagrant me Kushtetutën e Republikës së Shq-

ipërisë e cila parasheh ndarjen e fesë nga politika. Fakti që ne na habit dhe indinjton me Meshën tuaj, është se kjo iniciativë po ndërmerret nga ana juaj në një moment kur në shtetin të cilin ju përfaqësoni, debatet mbi çështjen e laicitetit të shtetit ngihen sa herë që dikush paraqitet në bankat shkollore me ndonjë pjesë të dukshme të besimit të tij / saj dhe kur çështje të këtilla sulmohen sa nga mediat aq edhe nga politika shqiptare me justifikimin e garantimit të bashkjetesës fetare në Shqipëri. Por në kundërshtim me mendimin civil të shoqërisë shqiptare ju jeni duke vepruar në një mënyrë totalisht të kundërt. Një fakt që i ka shtuar indinjatës sonë edhe më shumë shqetësim është fakti që në njoftimin tuaj mbi organizimin e Meshës së Nënë Terezës (të cilin ju e legjitimoni si një akt patriotik) ju këshilloni bashkatdhetarët tanë në Kanada që të mos mbajnë flamuj kombëtarë. Me këto veprime kur ju i kërkon bashkatdhetarëve tanë që të vinë në një MESHË katolike dhe të evitojnë simbolet tona kombëtare, ju jeni duke u pozicionuar si PËRFAQËSUES i Kishës Katolike dhe jo i Shtetit Shqiptar. I dashur z. ambasador! Meqënëse deri në këto momente që ne po shkruajmë këtë letër ju nuk i jeni përgjigjur kontaktive tona të mëparshme private mbi këtë Meshë, ne po detyrohemi që të ju adresojmë në mënyrë publike dhe të ju kërkojmë publikisht që zyra juaj, përfaqësuese e Republikës së Shqipërisë në Kanada të mos përzihet në organizimin e ceremonive fetare si Meshë në fjalë. Duke lënë fenë jashtë politikës dhe respektuar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ne be-

sojmë se ju do të kontribuoni në ruajtjen e "bashkëjetesës fetare" të popullit shqiptar. Pakënaqësinë dhe indinjatën tonë lidhur me veprimin tuaj ne po i'a përcjellim edhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, si edhe shumë mediave shqiptare dhe organizatave të shoqërisë civile, misioni i të cilave është ruajtja e bashkëjetesës fetare në mesin e shqiptarëve. Ju falenderojmë paraprakisht, Një grup bashkatdhetarësh me banim në Kanada

Arbër	Fetiu,	Quebec
Dritan	Basha,	Toronto
Jeton	Hoxha,	Toronto
Kujtim	Elmazi,	Toronto
Lulzim	Ismaili,	Montreal,
Serxhan	Mustafai,	Toronto
Bekim	Hoxha,	Toronto
Faton	Hoxha,	Toronto
Shpendi	Osmani,	Toronto
Adem	Kamberi,	Toronto
Bujar	Zejnullahu,	Toronto
Faton	Hoxha,	Toronto
Fatmir	Fetiu,	Quebec
Asip	Ahmeti,	Toronto
Zyber	Elmazi,	Toronto
Mirlin	Sherifi,	Toronto
Bujar	Zeqiri,	Toronto
Ylli	Shabani,	Toronto
Gezim	Hoxha,	Calgary,
Valbon	Shabani,	Toronto
Arben	Lumani,	Toronto
Ali	Beqiri,	Toronto
Ngadhnjim	Fetiu,	Quebec,
Allber	Elmazi,	Toronto
Fitim	Jusufi,	Toronto
Jeton	Memeti,	Toronto
Senad	Zyberi,	Toronto
Albert Gjoci,	Quebec	

## ZOTI ËSHTË NJË

Për çdo t' lumën ditë  
Si me qenë n' pazar  
Dëgjohe ndër shqiptarë  
Një fjalë me zarrar:  
Zoti kryetar,  
Zoti kryeministër,  
Zoti minister,  
Zoti deputet,  
Zoti drejtor,  
Zoti filani...  
Sa m'u çuditë  
Dreqi, shejtani!  
Sa pak shqiptarë,  
Kaq shumë hyjni!  
A ka gjuhëtarë,  
E shkreta Kosovë!?  
E mjera Shqipëri!?  
Është një Zot,

Mexhid Yveysi

## VJEN TEK UNE PAPRITUR...

Dikush vjen tek une e me trondit, si fortune me tund me shkund.  
Me therret prej enderes se fjetur, qe thelle terheq ne iluzione  
Ma kthjellon imazhin, me zgjon.  
Je ti, profet i njerezve qe me therret ne drite  
Me ngarkon me fjale, me qeteson, me ngushellon.  
Me fut ne turmen e njerezve besnike me hapa drejt teje.  
Te thane poet, por poet nuk je.  
Je dore e ngrohete mbi koken e bonjakut,  
Sherim i embel i zemrave te semura.  
Drejtasi, fisnikeri prej dijes se pashkolle buron nga i vetmi Zot.  
Prej shpelles Hira filloi misioni i rende e bartet nder shekuj  
E ngjizet magjishem ne mendjet njerezore.  
Mrekulli hyjnore perhere e re permes njeriut profet ne zemra  
fisnike.  
Dhe vjen tek une.  
Me tund ,me shkund

Samir Hoxhiq  
Medrezeja Haxhi Sheh Shamia  
Viti iv



# 6 PIKAT BAN KI MUN JANE 6 PIKA HELMI PER KOSOVEN

Kur Kosova e shpalli Pavaresine, pak kush e dinte se kjo do te ishte nje Pavaresi e brishte dhe e kufizuar e cila do te na kujtonte jo shume vone se "Dardha e ka bishtin prapa". Pasi i la kosovaret dhe miqte e tyre qe te "harliseshin" me gezimin e Pavaresise, bashkësia nderkombetare, alias Evropa e bashkuar kunder Kosoves, filloi pazarlleqet me Serbine duke synuar qe t'ia ngushtoje sa me shume hapësirën shtetit te ri te Kosoves dhe t'i krijojte kushte te reja Sebise qe ajo te kete mundesi te marre revashin per humbjen e Kosoves dhe ta ktheje ne humbese te vertete Kosoven permes nje beteje diplomatike ku ajo ka mbeshtetje nga "Nena Rusi" dhe nga motra e vjeter, Evrope. Mbi bazen e kesaj mbeshtetjeje, ajo arriti te realizojte nje "mbleseri" te re me OKB, ku rri ne karriken e drejtuesit nje korean i shkurtër qe quhet Ban Ki Mun, i cili mbahet mend per strukjen e tij te frikshme poshte nje karrikeje, kur perjetoi ne Bagdat nje sulm me bomba ndaj godines ku ai ishte atashuar gjate nje vizite ne Irak. Pasi plani u projektua pas kuintave dhe iu dha edhe "nje

dore" e fundit, ai doli ne publik si propozim i OKB per te qetesuar situaten ne Kosoven e Pavarur dhe per t'i bere palet te rrine se bashku "Ne nje tryeze" ku rrijne ata ,qe pas shume perpjekjesh, jane pajtuar. Por, qeveria e Kosoves dhe vete presidenti Sejdiu e denoncuan kete plan 6 pikesh si nje akt qe rrenon Pavaresine e Kosoves dhe ben faktike ndarjen e Kosoves sipas vijave etnike dhe fetare, duke realizuar ate qe bashkësia nderkombetare realizoi ne Bosnje, pasi lejoi nje masakër te permasave te ashpra sidomos kunder bashnjakeve muslimane. Edhe ne keto momente, kur po hidhet ne kompjuter ky shkrim, presioni ndaj qeverise se Kosoves eshte ne rritje qe ajo te pranoje 6 pikat e Ban Ki Mun qe jane faktikisht 6 pika helmi per Kosoven dhe kosovaret. Ky plan ogurzi eshte nje dhurate e rralle per serbet e Kosoves dhe te Beogradit, sepse ai e ben realitet ndarjen e Kosoves duke e lene jashte territorit administrativ veriun e Kosoves, ku kosovaret as qe lejohen qe te kthehen ne shtepite e tyre. Dhe per serbet e Kosoves dhe te Beogradit, ne keto momente, miku me i

mire duket se eshte Unmiku i cili ka kohe qe mbeshtet interesat e Serbeve ne Kosove dhe penalizon e ndeshkon kosovaret qe jane ne token e tyre. Duke se plan i OKB ka marre pamjen e nje thike e cila po i ngulet Kosoves pas shpine per hir te aleancave te vjetra dhe te reja qe shtete potenciale evropiane kane me Serbine te cilen duan ta favorizojne duke e bere pjese te BE , duke e nxerre njekohesisht te lare per kasaphanen qe shkaktoi ne Ballkan ne emer te nje Serbie te Madhe e cile vazhdon te mbetet nje ender qe ua prish gjumin serbeve ,kur kujtojne se ajo mbeti vetem nje ender edhe pas asaj gjakderdheje qe ua mori jeten qindra dhe mijra njerezve te pafajshem, ku shumica e viktimave ishin muslimanet e Bosnjes dhe muslimanet e Kosoves. Ngjarjet qe do te pasojne planin e rrezikshem te OKB, do te tregojne se kush e ideoi ate dhe cili do te jete skenari i tjetër i rralles qe do te provoje ne shpine Kosova dhe kosovaret . Por nje gje eshte shume e sigurte. Te gjitha alternativat qe do te hidhen ne tryeze per te kenaqur palet do te jene gjithmone pika helmi per Koso-

ven, sepse ideatore dhe planifikues per zgjidhjen e problemeve qe kane te bejne me shtetin e pavarur te Kosoves vazhdojne te jene ata shtete qe e paten shkeputur hapësirën kosovare nga trangu i Shqiperise per t'ia dhene ate Serbise. Por kohet kane ndryshuar dhe tashme kosovaret "kane marre zemer" dhe po u pergjigjen me nje "Jo" te forte edhe "miqve" qe po u kundervihen interesave te shtetit te lire dhe te pavarur te Kosoves. Ne deshirojme qe zgjidhjet te jene "te buta" dhe paqesore, sepse ata qe bejne plane vrastare ndaj Pavaresise se Kosoves, nuk do te ngurojne te ndezin nje zjarr te ri ne Ballkan ku viktimat kesaj ralle mund te jene ne permasa te frikshme. Por, qeveria e Kosoves dhe miqte e vertete qe e mbeshtetin ate, duhet t'i kepusin fijet e bashkepunimit ne mes te Serbise dhe qarqeve antishqiptare evropiane, sepse vetem keshtu Kosova dhe Ballkani do te kthehen ne nje oaz paqeje dhe jo ne nje fuci baruti.

Selim Gokaj

## NDARJA E KOSOVES ESHTË FAKTIKE

Gjatë vizitës te komunave të Kosovës në kuadër të të ashtuquajturës "Java e Kuvendit nëpër komuna", kryeparlamentari Jakup Krasniqi me anëtarët e kryesisë së Kuvendit të Kosovës si dhe deputetët e rajoneve, mbajtën takime me kuvendarët komonale dhe qytetarët e komunave. Në njërin prej debateve të mbajtura, mora pjesë edhe unë, me ç'rast edhe parashtrova pyetjen me këtë përmbajtje: Duke marrë parasysh thënien e njohur "politika është art i të mundshmes", dhe se meqenëse akoma na mungojnë futurologët politike në nivel shtetëror të cilët vëzhgojnë, përcjellin, analizojnë dhe parashikojnë zhvillimet aktuale politike ndërkombëtare në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë të cilët i japin kahje veprimeve politike, diplomacisë shtetërore dhe marrjen e vendimeve konform situatës dhe rrethanave aktuale që veprojnë në arenën politike ndërkombëtare, plasimi i idesë serbe, gjegjësisht të kryetarit serb Tadiç, për ndarjen e Kosovës si solucion i fundit i mundshëm, në rrethanat e tanishme doli haptas në shesh nga sirtarët në të cilin është mbajtur një kohë të gjatë. Kjo ide e plasuar, pas së cilës pason lobiimi dhe marrja përkrah në njërin anë të përkrahësve të saj, Rusisë apo edhe të Kinës në Këshillin e Sigurimit, dhe në anën tjetër të Spanjës apo edhe të Greqisë në Bashkimin Evropian, si shtytje drejt faktorëve ndërkombëtar vendimmarrës, që në hapin e fundit të jetë një kompromis i mundshëm drejt pranimit të pavarësisë së Kosovës dhe anëtarësimit të saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, Bashkimin Evropian, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian si dhe institucionet tjera relevante ndërkombëtare. Nëse eventualisht edhe faktori politik

vendimmarrës ndërkombëtar, pikësëpari mendoj në SHBA, Britaninë e Madhe, Gjermaninë, Francën dhe Italinë, pajtohet dhe bie dakord me këtë qasje, si mundësi reale drejt arritjes së stabilitetit politik ndërkombëtar në nivel global është e pritshme se do të bëjnë trusni tek krerët shtetëror kosovare për të pranuar këtë qasje eventuale, parashtror pyetjen se institucionet tona shtetërore, pikësëpari mendoj në presidencën, qeverinë, parlamentin, a kanë ndonjë plan veprimi alternativ, po qe se ballafaqohen me këtë skenar të mundshëm eventual në nivel ndërkombëtar, që sipas mendimit tim, i vetmi kompromis i mundshëm dhe pranueshëm eventual, do të ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë. Edhe pse e kisha te qarte se nuk do të marrë përgjigje adekuate, pyetja ime u kualifikua vetëm si tepër e vështirë dhe hipotetike, por qëllimi im ishte më tepër i karakterit të sensibilizimit të opinionit publik si dhe përcjellja e mesazhit nëpërmjet mediave elektronike dhe të shkruara, për një qasje reale të pritshme që Kosova do të mundet të përballet gjatë periudhës së ardhshme. Nuk kaluan as 48 orë pas debatit në fjalë, kur ndërmjetësi i OKB-së solli propozimin për ndarje administrative të Kosovës gjatë takimeve që i pati në Beograd dhe Prishtinë, shkruanin mediat elektronike dhe të shkruara, duke elaboruar, se në veri të Kosovës do të vendoset shërbimi i veçantë doganor dhe shërbimi i ndarë policor. Por, më e keqja qëndron, se mjetet e grumbulluara nga dogana e ndarë e Veriut, do të mbeteshin serbëve lokale që gjenden aty dhe kjo do të ishte "gjuajtja e një plumbi me dy caqe të shënuara", pasi që i tërë eksporti i mallrave nga Serbia dedikuar Kosovës, do të orientohet drejt dy portave hyrëse në veri

të Kosovës me ç'rast, përveç përfitimit të Serbisë nga shitja e mallrave tregut kosovar, do të përfitonit edhe serbët lokal nga mjetet e grumbulluara në dogana. Kjo ndarje administrative e propozuar është hapi i parë drejt ndarjes faktike në fazën tjetër. Pas kësaj, në një intervistë të dhënë, ambasadori britanik në Beograd në pyetjen se a mund të jetë ndarja e Kosovës zgjedhje përfundimtare e çështjes së Kosovës, përgjigjja e tij ishte po, në rast se pajtohen të dyja palët. Duke marrë parasysh deklaratat e shpeshta të kryetarit serb Tadiçit, se nuk mund të jetë zgjidhja përfundimtare pavarësia e Kosovës, pasi që njëra palë humbet tërësisht (aludon në Serbinë), ndërsa pala tjetër përfiton absolutisht (aludon në Kosovën), duke nenkuptuar haptasi ndarjen e Kosovës, që Serbia të mos dalë humbëse, por sikurse në rastin e Bosnjës, nëpërmjet Republikës Serbe, arriti de facto të ndajë Bosnjën, duke kontrolluar gjysmën e territorit të saj, tani përpiqet atë të arrijë edhe në Kosovë, duke ndarë ¼ e territorit të Kosovës, të cilin faktikisht nëpërmjet institucioneve paralele edhe i kontrollon. Ideja e Serbisë së madhe në linjën Karlovac- Karlobag njëherë e përgjithmonë ka marr fund, të cilin në mënyrë publike e pranoi edhe ish politikani radikal serb Aleksandar Vuçiçi, dhe se tani e tutje interesi serb do të përqendrohet për serbët matanë Drinës në Bosnjë dhe për serbët në Kosovë, e kjo do të thotë tani e tutje jo Serbi e Madhe, por Serbi e Zgjeruar në kufijtë brendshëm të Bosnjës dhe Kosovës. Insistimi i përhershëm i Serbisë për zgjerime dhe ndarje territoriale të Bosnjës në njërin anë dhe të Kosovës në anën tjetër, qëndron në atë, se në qarqe të caktuara evropiane ka simpati dhe mbeshtetje për

zgjidhjen e çështjes serbe drejt zgjerimeve territoriale në Bosnjë dhe Kosovë, si hap i parë në ndarje administrative. Për këtë arsye edhe institucionet tona shtetërore duhet të jenë të gatshëm, në rast ballafaqimi dhe mbeshtetje për mur nga faktori politik vendimmarrës botëror, me planin alternativ, që do të ishte përkufizimi në linjë të re kufitare të serbëve dhe shqiptarëve. Nëse eventualisht, veriu i Kosovës do të duhej ndarë nga Kosova, pse nuk do të mund të ndahej Lugina e Preshevës nga Serbia, normal me pajtimin eventual të dyanshëm, edhe të serbëve edhe të shqiptarëve, nën trusninë e faktorit politik vendimmarrës botëror? Si përfundim i kësaj logjikisht do të ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, si zgjidhje reale e çështjes shqiptare. Serbia e di se më nuk mund të kontrollojë më Kosovën, e lere më të zhbëjë pavarësinë e saj, të pranuar gjer më tani nga 52 shtetet të OKB-së. Por ajo, me një diplomaci aktive dhe të pandërprerë, është duke promovuar idenë e saj për ndarjen e Kosovës, për të përshpejtuar procesin drejt anëtarësimit të saj në Bashkimin Evropian. Ajo është e vetëdijshme se për të arritur aty, patjetër duhet zgjedh problemet kontestuese apo territoriale dhe se është duke përdorur të gjitha mjetet diplomatike e politike duke bërë trusni tek faktorët relevant ndërkombëtar për zgjidhje sa më parë, për arritjen e saj drejt fitimit të kandidatit potencial për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Do e cekë në fund të këtij vështrimi se dita më ditë ndarja e Kosovës është më shumë gjendje faktike sesa hipotetike.

2.11.2008  
Faik MIFTARI

# A ESHTË SHAMIA SULM MBI SHOQERINE DEMOKRATIKE?

Njerëzit fisnikë ndaj grave të tyre janë bujarë dhe të kujdesshëm. Përçmimi dhe dëmi ndaj tyre mund të ndodh nga njerëzit me karakter të ulët dhe të dëmshëm. Lëndimet, sprovat dhe vuajtjet janë reale në histori dhe duhet të shërbejnë si mësim që mos t'i përsërisim gabimet dhe mëkatet. Pas sprovave dhe vuajtjeve njeriu çlirohet nga prangat e mosnjohjes dhe zemra e njeriut më qartë se deri atëherë e njofton bukurinë e mirëfilltë të fesë së vërtetë. Ndaj, muslimanja e njofton vetë fenë e saj dhe nuk pret të urdhëresë prej kryetarëve shtetërorë që t'ju flasin për fenë e tyre dhe të drejtat e tyre. Muslimanja në përgjithësi dhe ajo shqiptare në veçanti nuk kërkon dhe nuk pret të vendim dhe leje të Fatmir Sejdiut, Merkelit, Sarkozit, Bushit, Putinit e shumë të tjerëve si ta njohë dhe mësojë fenë e saj, a duhet të bartë shami, apo duhet të zhvishet. Nëse jomuslimanja ka të drejtë të zgjedh mënyrën dhe llojin e veshjes, edhe muslimanja ka të drejtë në zgjedhjen e veshjes dhe mënyrën e llojin e saj. Për pozitën e femrës në Islam është shkruar, folur e përfolur mjaft. Pa marrë parasysh çka është folur deri tash, sërish duhet të flitet për rolin dhe rëndësinë e saj në shoqëri dhe familje në kohën e ngatërrimit të vlerave dhe pavlerave. Mendimet tendencioze dhe abuzive për pozi-

tën e femrës në Islam shpesh herë gjejnë hapësirë si në botë ashtu edhe te ne. Jemi dëshmitarë të abuzimeve ndaj femrës muslimane në shumë vende të botës, por edhe në Shqipëri, Kosovë e vende të tjera. Fanatikë shekularistë, antimuslimanë, në vazhdimësi provokojnë ndjenjat muslimane, duke atakuar vlerën më të madhe, femrën, e cila me veshjen e saj ngjason në perlën e cila strehohet në guacën e saj. Intelektuali i njohur musliman, Zijauddin Serdari, duke e komentuar aferën e shamisë në Francë, me gjysmë ironi thotë: Thus, a French woman with a scarf is chic, but a Muslim woman with a scarf is a threat to civilization! "Ndaj, francezja me shami është shik (simpatike), kurse femra muslimane me shami është kërcënim për qytetërimin." Pse ky panik?, pse ky alarm?, për shkak të femrës muslimane me shami në kokë? Përse gjithë kjo rrëmujë për femrën muslimane me shami? Ata thonë: Dëshirojnë që femrën muslimane ta çlirojnë nga mesjeta? Por, përse, nga kush në mesjetë? Ata thonë: Ta çlirojnë nga feja dhe nga bindja ndaj Zotit! Mirë, ta çlirojmë nga feja dhe nga bindja fesë islame, por çka ofroni si zëvendësim në vend të fesë islame dhe të shamisë? Atathonë: Lumturinë! Ohoho! Ç'është lumturia?, kujt i thoni "lumturi", zotëri? Heqjes së

shamisë dhe Lakuriqësisë? Absurd! Është i njohur rasti i një artisteje franceze, e cila para kamerave televizive ka prezantuar një skenë plotësisht e zhveshur. Në një moment u bë hysterike, bërtiti në drejtim të artistëve dhe regjisorit: "O qenë, ju nuk jeni njerëz, ju nuk dëshironi me ne femrat tjetër gjë pos trupit tonë, në mënyrë që të bëheni milionerë në kurrizin tonë!" Pastaj u kthye duke qajtur. Tërë kjo fletë për vuajtje të mëdha, të cilat me perfiditet fshihen, por këto vuajtje megjithatë janë të qarta. Për femrat e zhveshura shekullaristët thonë se janë më moderne, më të qytetëruara dhe më të kulturuar se femrat muslimane, por mallkuar qoftë ai modernizëm, ai qytetërim dhe ajo kulturë që për vlerë e quan lakuriqësinë dhe kënaqësinë ekreivatit.

Me apo pa dëshirë, duhet të pranojmë se femra sot është bërë mjet i mirë për sendërtimin e interesave të meshkujve dhe kompanive mafioze. Me të drejtë Evropë-perëndimi e atakon femrën muslimane sepse në të sheh pengesën e fundit dhe të vetme, barrikadën e fuqishme ndrejtegoizmit dhe pangopësisë së tyre. Bota moderne pretendon se ka arritur ta barazojë femrën me mashkullin, por harrojmë se bota moderne e barazoi femrën në atë që nuk është femëro-

re. Modernja e bëri femrën objekt publik admirimi dhe shpërdorimi, ia mori personalitetin, vlerën femërore dhe vetëmohimin e saj. Nga pozita e nënës, e zonjës dhe e menagjerit familjar, femra është transformuar në manekene, fotomodele, në objekt bordelesh, në një "kafshë e mirë" për të plotësuar afinitetet dhe obskurantizmin mashkullor. Deri sa në Islam femra ishte lule në mes shumë luleve në kopsht, femra në qytetërimin modern ubëuleq ëhedhet në rrugë, qënë për këmbet dhe epërçmohet. Por, për këtë arsye, ne muslimanët nuk i urrejmë të tjerët por e urrejmë të keqen që serviret si vlerë dhe është rrënjësuar në kokat dhe qenien modernistëve. Është e qartë se shamia nuk është sulm mbi vlerat demokratike, sepse sulm mbi këto vlera është lakuriqësia dhe çoroditja morale e motivuar me interesa politike dhe ekonomike. Vallë, do të kthjellen kokat e qeveritarëve dhe intelektualëve tanë dhe angazhimin e tyre do ta orientojnë drejt të keqes e jo drejt të drejtave më elementare individuale dhe fetare në shoqërinë tonë në Kosovë dhe në trojet shqiptare.

Nexhat Ibrahim

Kosovë

## HOLLANDA DO TE NDALOJE ME LIGJ PERDORIMIN E SHAMISE NGA GRATE DHE VAJZAT MUSLIMANE

Mediat e huaja bejne te ditur se institucinet shteterore vendimmarrese ne Hollande kane vendosur qe te ndalojne me ligj perdorimin e shamiave nga grate e vajzat muslimane qe jetojne ne Hollande.

Ky ligj persekutor do te veproje ne shkolla publike dhe private, pa harruar se ai eshte ekzekutues edhe ne ambjete publike. Axhensite e lajmeve nuk tregojne per llojin e masave me te cilat do te ndeshkohen grate dhe vajzat muslimane qe do te perballen me kete ligj qe cenon

lirine fetare dhe godet identitetin fetar te bashkesise islame ne Hollande.

Me kete akt Hollanda behet pjese e histerise antiislame qe penalizon shamine muslimane i cila njohu nje kurbe te larte, kur nje ligj thujse te ngjashem aprovoi edhe Franca qe mburrret per shkallen e larte te demokracise, demokraci qe nuk e shtrin rrezin e saj tek te drejtat e religjonit islam. Me kete ligj, qe do te filloje te funksionoj shume shpejt ne Hollande, grate e vajzat muslimane do te mbajne

shamine vetem mrenda mureve te shtepive, ose te apartamenteve ku ata jetojne. Nuk dihet ne se ky ligj do te penalizoj edhe murgeshat katolike te cilat kane edhe ata shamia dhe pa tjetër qe ne Hollande nuk mungojne. Autoritetet hollandeze ka mundesi te gabojne, kur mendojne dhe veprojnë kunder muslimaneve duke ashpersuar ligjet e veta qe jane cenim i vlerave te demokracise perendimore pjese e se ciles ata e kane deklaruar vëhten e tyre. Por emri i Hollandes eshte tashme i njollosur edhe

nga bashkepunimi i ushtareve hollandeze me serbet ne masakren e Srebernicës, ku u vranë mbi 11 mijë djem dhe burra boshnjake per te vetmin faj se ishin muslimane dhe si te tille duheshin shfarosur. Keto ushtare ishin ata qe moren medalje pasi u kthyen ne Hollande per "sherbimin kualitativ" ne rrallet e forcave paqeruajtese ne vitin 1992-1995 ne Bosnje.

*Materiali eshte marre nga mediat e shkruara.*



## ROLI I INTELEKTUALËVE MUSLIMANË SHKODRANË NË JETËN SHOQËRORE TË QYTETIT GJATË SHEKULLIT TË 19-TË DHE GJYSMËS SË PARË TË SHEKULLIT 20-TË, NJË SHEMBULL PËR T'U NDJEKUR NË TREVAT E TJERA SHQIPTARE

Qenë zhvillimet ekonomike dhe politike gjatë mesit të shekullit XVIII e këtej, që sollën zhvillime shoqërore kulturore të një rëndësie të veçantë për Shqipërinë<sup>1</sup> e në mënyrë të posaçme për Shkodrën, kryeqendër e pashallëkut homonim, që po njihje sundimin gati shekullor të Bushatllinjve. Me një politikë të mençur, jo vetëm në planin ekonomiko-politik, ata u hapën rrugë edhe dukurive qytetëruese e emancipuese në rrafshin arsimor e kulturor. Studiuesit e historianët argumentojnë qartë, se "...bashkë me mallrat, Shkodra solli në Shqipëri..." edhe jehonën e frymën demokratike të parimeve të iluminizmit evropian dhe se Bushatllinjët e kishin të qartë, që për t'u shkëputur nga Turqia duhej kulturë e përvetësim i dijeve të kohës<sup>2</sup>. Kështu, me interesimin e drejtpërdrejtë të tyre u ndërtuan objekte kulti, xhami, teqe, vepra infrastrukturë si rrugë, ura, hane, banjo, bezistene, dhe gjithashtu edhe medrese e biblioteka. Është e dokumentuar tashmë se ato, duke qënë të shkolluar në institucionet arsimore të zgjedhura të aristokracisë osmane, qenë adhures edhe të poezisë dhe të letërsisë orientale, veçanërisht asaj persiane, madje ngulmohet se ato kanë qenë vetë krijues poezish sipas atyre modeleve. I tillë ka qënë vetë Ibrahim Pashë Bushatlliu (i mbiquajtur Halil), si dhe nipërit e tij, Mehmet Asafi, Hasan Hakiu dhe veziri i fundit, Mustafa Pasha (i mbiquajtur Sherif)<sup>3</sup>. Medreseja e Qafës e Mehmet Pashë Plakut, e ndjekur nga simotra e saj, Medreseja e Pazarit, vepër e Kara Mahmut Pashës, që së bashku me Bibliotekën e rindërtuar nga Mustafa Pasha u kthyen në një ansambël arsimor-kulturor<sup>4</sup>, u bënë vatra që rrezatuan dije e kulturë për dekada e dekada. Duke u kthyer në vakuf, pra, pronë publike, Biblioteka e Bushatllinjve u bë institucioni kulturor unik i llojit të vet për krejt rajonin, me një fond të pasur librash ku titujt e veprave letrare e diturore qëndronin pranë atyre të teologjisë. Historianët e kanë vlerësuar lart këtë klimë të shëndetshme për zhvillime pozitive në fushën e kulturës e të mendimit. Ja një nga këto vlerësime: "Pikërisht në shekullin XVIII u hapën përsëri dritaret e flladit evropian... në hapjen e këtyre dritareve ndikuan edhe vetë krerët e pashallëqeve shqiptare, në mënyrë të veçantë Kara Mahmut Pasha në Veri e Ali Pashë Tepelena në Jug, të cilët i zgjeruan kontaktet me vendet perëndimore"<sup>5</sup>. Një mjedis i tillë arsimdashës që faktor i krijimit të një elite hoxhallarësh të ditur si Myrteza Efendi Shoshi, Jusuf Tabaku, i njohur për krijimin e bibliotekës

aq të pasur "Këlliçi", Sali Efendi i madh, Selim Ef. Fakja, Sheh Shamia etj., të cilët vunë bazat e asaj tradite të lartë e të gjatë në lëmin arsimor-kulturor. Falë informacioneve me shumë interes të autorit turk Ali Emiri<sup>6</sup>, marrim vesh se krijimtaria e poetëve shkodranë përfshinte një plejadë autorësh të talentuar, mes të cilëve shkëlqente Myrteza Sali Efendi (alias Myrteza Ef. Shoshi) me të nipin, Raxhi Shkodrani (alias Abdul Myrteza Zai Efendi). Një terren kaq pjellor dhe cilësor, ku krijuan dhe u afirmuan më se 20 poetë u bë shtrati me i përshtatshëm dhe më premtues për fillimin e vjershërimit në gjuhën amtare, duke i dhënë krah asaj dukurie letrare për kohën që njihet me emrin alamiada shqiptare, e që njohu talente të tilla si Molla Hysen Dobraqi (i mbiquajtur Anakreonti i Shqipërisë nga rilindasi Zef Jubani) dhe Molla Sali Pata, emra të nderuar të trashëgimisë sonë kulturore. Shkodrës dhe kulturës së saj i bënë nder fakti, që në gjirin e saj alamiada shqiptare u ndje ngruhtë dhe njohu një ecuri të mbarë. Duhet të jemi gjithashtu të vetëdijshëm, se edhe me parë, ndonëse nëpërmjet gjuhës e formës orientale, poetët shqiptarë kanë përcjellë mesazhe humanizmi, me frymë liridashëse, si vetë natyra e letërsisë dhe e poezisë persiane, kulmet e së cilës janë thesare të letërsisë botërore. Mjafton t'u referohemi vlerësimeve brilante të të madhit Gëte dhe të Nolit tonë, me anë të cilave ata patën nënvizuar dhe ndikimet e drejtpërdrejta të asaj kulture, së bashku me qytetërimin islam, në burimet e Rilindjes Evropiane e si rrjedhojë në themelet e qytetërimit të sotëm. Sidoqoftë me atributet që Shkodra fitoi nën Bushatllinjët, si bërthamë e shtetitë ardhshëm shqiptar, si metropol i madh i zhvillimit ekonomik e shoqëror dhenjëherazi laborator kryesor i mendimit shqiptar dhe i krijimit të vlerave shpirtërore kulturore, edhe pas rënies së këtij pashallëku, ajo do të vazhdojë të ruajë frymën luftës për liri dhe përparim. Kjo atmosferë e ndezur dhe plot tension, e mbajtur gjallë edhe nga vargjet e poetëve popullorë që u këndonin bëmave të "vaktit të Vezirëve", i pat përcjellë djemtë e Shkodrës dhe të Malësisë në kryengritjet e përhershme kundër arbitraritetit të valinjve osmanlinj, ose në përleshjet me fqinjët shovenë e të pangopur. Qenë burrat e ditur të Shkodrës, Jusuf Tabaku, Hafiz Hyloja, Sheh Shamia, Daut Boriçi, Ahmet Kalaja, Ferhat Dragusha, H. Hasan Tamizi, Selim Ef. Çoba, H. Ali Ulqinaku etj, që diploma e fituar në

Stamboll, ose rroba fetare nuk i pengoi të ishin në krye të luftëtarëve ose përkrah tyre, duke dhënë "fetva" mobilizuese<sup>7</sup>. Kongresi i Berlinit i ndjekur nga Lidhja e Prizrenit, me vitet dramatike që prinë, ose që i shoqëruan i mësuan shqiptarët se në çdo çast lufta me armë duhej shoqëruar edhe me luftë diplomatike. Arkivi i ish-konsullatës Austro-Hungareze në Shkodër na zbulon një episod të natyrës së mësipërme, jo i evidentuar deri tani nga historiografia jonë. Është një raport i prag viteve 1877-78, që ish-konsulli austro-hungarez, Lipihu i dërgonte nga Shkodra eprorit të vet në Vjenë, kontit Andrassy<sup>8</sup>. Aty thuhej se në Shkodër "ekziston një e ashtuquajtur parti muhamedane", e cila që para një viti "mban lidhje me dragomanët e konsullatës italiane si miqtë e saj katolikë". Pasi nënvizohet se "shumica e muhamedanëve të kësaj partie rrjedhin nga familja e Bushatllinjve dhe të afërmit e saj", pasi i identifikon tre nga Bushatllinjët udhëheqës, i bënë të ditur se ato po mbledhnin 100-150 përshtetë, ku nja 30 ishin të katolikëve, për një peticion drejtuar qeverisë italiane për t'i kërkuar asaj përkrahje për "muhamedanët e Shkodrës dhe të gjithë Shqipërisë së Veriut" ndaj kërcënimeve të rrezikut malazez. Ky hap sipas Lipihut ndërmerrej pasi Fuqitë e Mëdha, përfshi dhe Austrinë, nuk po i përfillnin kërkesat e tyre për përkrahje, ndërsa Italia shteti i ri dhe ambicioz u ngjallte besim. Pavarësisht rezultatit, peticioni i projektuar tregonte pjekuri politike, përderisa është një tregues i kapërcimit të paragjykimëve e të mëdyshjeve të çastit në interesin madhor politik të vendit, duke qënë njëherit shprehje solidariteti e bashkëpunimi midis dy komuniteteve, provë emancipimi shoqëror në drejtim të organizimit politik, qoftë embrional e diletant, provë orientimi pro-perëndimor. Duke qënë e njohur dukuria e baticave dhe e zbaticave në çdo lëvizje politike e shoqërore, edhe në periudhën që analizuam, pas Lidhjes së Prizrenit ndeshet një situatë "jo shpërthyes" dhe veprimtaritë atdhetare përqendrohen në aspektin arsimor-kulturor, kështu që nuk

duhet anashkaluar roli i atyre shkodranëve të ditur, në përgjithësi hoxhallarë, të cilët iu përkushtuan edukimit e shkollimit të brezave të rinj e jo vetëm në drejtimin teologjik. Edukimi me dashurinë për vendin, për dijen, në frymën e tolerancës, vëllazërimit e të përparimit karakterizuan gjithë jetën e veprimtarinë e burrave të tillë si H. Ibrahim Kaduku, H. Halit Bushati, H. Sheuqet Boriçi, Sali Myftia, H. Ymer Bakalli, H. Muhamet Bekteshi, H. Abdulla Bërdica, H. Adem Kazazi etj, që në pjesën dërrmuese çmoheshin edhe jashtë vendit për kulturën e tyre jo vetëm fetare. Provë e këtij pohimi qenë bibliotekat e tyre të pasura, që me larminë e tyre në tematikë e në gjuhë të huaja, jo vetëm orientale, kanë impresionuar dhe vizitorët të huaj. Në prag të shekullit XX shtresa e njerëzve të shkolluar ishte e vetëdijshmetashmë se shkëputja eminente nga Porta e Lartë nuk do të kufizohej vetëm meshkëputjen në planin politiko-juridik. Shteti i ri shqiptar do t'i shkëpuste lidhjet evarësisë së deriatëhershme arsimore e kulturore me Stambollin, qendër e qytetërimit osman, ndonëse dhe aty si metropol kozmopolit ishin krijuar mjedise liberale mendikime perëndimore. Shkodra, ashtu si mbarë Shqipëria, historikisht ka qënë një urë lidhjeje në mes Lindjes e Perëndimit, prandaj shkodranët e arsimuar i vunë vetes detyrën që në formimin e tyre intelektual duhej të harmonizonin kulturën orientale me atë perëndimore. Arma më e mirë në këtë drejtim ishte perfeksionimi i frëngjishtes, si gjuhë e kulturës botërore, që kishin filluar duke e mësuar që në bankat e gjimnazit turk. Prania për vite të tëra e ushtrive të huaja në qytet, kryesisht asaj austro-hungareze e asaj italiane i dhanë dorë mësimi të gjermanishtes e të italishtes, krahas frëngjishtes. Ndihamuan dhe programet e gjimnazeve: Saverian (jezuit) dhe "Illyricum" (franceskan). Po t'i hidhej një sy bibliotekave private të kohës do të ishim dëshmitarë të fjalorëve e manualeve gjuhësorë.

NEXHMI BUSHATI



## Space-center

Qendra e internetit space-center ju ofron:

- internet te shpejte,
- shperndarje interneti,
- programe te ndryshme,
- cd, dvd, mp3,
- servis kompjuterash
- printime, skanime, etj.

Te gjitha keto me nje sherbim cilesor e te kulturuar.  
Jemi hapur cdo dite nga ora 08:00 deri 23:30.

Adresa: pallati xhenis pas rektoratit te universitetit  
"luigj gurakuqi", kati I

Kontakte:

- e-mail: spacecenter@live.com
- Cel. 0693253723 / 0672944162

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ  
BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIME

Tregtojme  
**MISH HALLALL**

E XHUMA PUSHIM → BESNIK ALUSHI ISMETI

**Produkt Hallall**

**KLIENTË TË NDERUAR!  
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,  
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

**1- Produkte mishi hallall si:  
sallam, suxhuk etj.**

**2- Piceri hallall**

**3- Fast Food hallall**

**Ju keni të drejtë të blini ku të doni  
por hallalli i vërtetë është vetëm  
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"  
Cel: 0692101893